



A.nr.33/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani anëtarë, me Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.33/2026, të datës 13.01.2026, të parashtruar nga ankuesi Y.D. nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Agjencia Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës, në çështjen juridike “*transferim i përhershëm*”, në mbështetje të nenit 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenit 16, paragrafi 3 dhe nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 30.06.2026, nxjerrë këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet ankesa më numër A.nr.33/2026, e datës 13.01.2026, e parashtruar nga ankuesi Y.D.

II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr.00006/2026, i datës 12.01.2026, i Drejtoreshës së Sekretarisë Ekzekutive në Agjencinë Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës.

A r s y e t i m

Ankuesi Y.D. (*referuar tutje vetëm ankuesi*), më datë 13.01.2026, përmes postes elektronike ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.00006/2026 i datës 12.01.2026, të Drejtoreshës së Sekretarisë Ekzekutive në Agjencinë Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës, për transferimin e përhershëm të ankuesit në pozitën Zyrtar për Administrim të Pronave në Departamentin për Koordinim Regjional, Zyra Regjionale në Prizren.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka procedura kërkesën për përgjigje në ankesë të Agjencia Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës KVK, ndërsa, kjo e fundit, ka përcjell përgjigje lidhur me pretendimet ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje të drejtë dhe meritorë ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 60/2026, të datës 13.01.2026, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin për parashtrimin e ankesës të datës 13.01.2026; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 09.02.2026; Raportet mjekësore; Ligji për Zyrtarët Publik; Kopjen e letërnjoftimit; Vendim për zbatimin e Vendimit me numër Ref.01088/25 të Komisionit Disiplinor me numër reference Ref.nr.00006/26; Përgjigjen në ankesë të datës 11.02.2026, me

të gjitha dokumentet e bashkangjitura nga organi i punësimit; Aktvendim i Gjykatës Themelore në Prishtinë me numër protokolli Nr.00177/26, i datës 02.02.2026; Vendim me numër reference Ref.01088/25, të datës 30.05.2025; Akt emërimi i ankuesit Y.D, me numër Nr.00122/2025, i datës 06.01.2025; Formularët e përshkrimit të punës; E-mail i datës 19.12.2025, për zbatimin e Vendimi të Komisionit Disiplinor, nr.Ref.01088/25; Njoftim për zbatimin e Vendimit të Komisionit Disiplinor, me E-mail i datës 12.01.2026; E-mail i datës 31.12.2025.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç, dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e pabazuar, *sepse*:

Nga administrimi i provave materiale të lëndës rezulton:

-Ankuesi fillimisht sipas Akt Emërimit me Nr. 00122/2025, të datës 06.01.2025, ka mbajtur pozitën Zyrtar për Pranim në Departamentin e Shërbimeve të Përgjithshëm në Agjencinë Kosovare për Krahxim dhe Verifikim të Pronës.

- Ndaj ankuesit ishte iniciuar procedurë disiplinore për shkelje të rënda disiplinore, kurse Komisioni Disiplinor i AKKVP më Vendimin Ref: 01088/2025 të datës 30.05.2025, ka shpallur përgjegjës ankuesin për shkelje të rënda disiplinore duke i shqiptuar masën disiplinore ***Transferim në pozitë të ngjashme në klasë dhe kategori të njëjtë.***

- Ankuesi kundërshton më ankesë Vendimin Ref: 01088/2025 të datës 30.05.2025 të Komisionit Disiplinor, ndërsa, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin A.nr.1245/2025, të datës 08.12.2025, ka refuzuar ankesën e ankuesit duke lënë në fuqi Vendimin Ref: 01088/2025, të datës 30.05.2025, të Komisionit Disiplinor të AKKVP-së.

-Në zbatim të Vendimit A Ref: 01088/2025 të datës 30.05.2025 të Komisionit Disiplinor, Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore me emailin e datës 19.12.2025, ka njoftuar ankuesin lidhur më pozitën e lira si: Zyrtar për përkthim-profesional 2, grupi i përkthimit dhe interpretimit; Zyrtar për Shqyrtim dhe Procesim të Kërkesave-profesional 2, grupi ligjor; Zyrtar për Administrimin e Pronave-Zyra Regjionale në Pejë-Profesional 2, grupi i administrimit të përgjithshëm; Zyrtar për Administrimin e Pronave-Zyra Regjionale në Prizren- profesional 2, grupi i administrimit të përgjithshëm dhe Zyrtar për Verifikimin e Dokumenteve, Zyra Regjionale në Prizren-profesional 2, grupi ligjor, duke e njoftuar tutje se sipas përgatitjes profesionale, plotëson kriteret për transferim në pozitën Zyrtar për Administrimin e Pronave-Zyra Regjionale në Pejë-profesional 2, grupi i administrimit të përgjithshëm dhe Zyrtar për Administrimin e Pronave-Zyra Regjionale në Prizren- profesional 2, grupi i administrimit të përgjithshëm, duke i kërkuar që deri më datë 22.12.2025, të deklarohej se cila nga këto dy pozita është e preferuara e tij. Ankuesi më datë 12.01.2026, përmes emailit ka njoftuar Udhëheqësen për Burime Njerëzore, për arsye e mia shëndetësore dhe të vajzës së mitur nuk ka mundësi të largohet nga Prishtina.

-Drejtoresha e Sekretarisë Ekzekutive në Agjencinë Kosovare për Krahxim dhe Verifikim të Pronës, më Vendimin Ref.nr.00006/26, të datës 12.01.2026, ka nxjerr me qëllim të zbatimit të Vendimit Ref: 01088/2025 të datës 30.05.2025 të Komisionit Disiplinor, duke e transferuar ankuesin në mënyrë të përhershme në pozitën Zyrtar për Administrimin e Pronave në Departamentin për Koordinim Regjional, Zyra Regjionale në Prizren, nga data 12.01.2026.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.00006/2026 i datës 12.01.2026, të Drejtoreshës së Sekretarisë Ekzekutive në

Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, pretendon se duke marr parasysh raportet mjekësore të tij dhe vajzës së tij, organi përkatës nuk i ka shqyrtuar në tërësi provat materiale duke shkelur parimin e proporcionalitetit dhe arsyeshmerisë e për rrjedhojë më janë cenuar të drejtat si nëpunës civil, pasi që vendimi i kontestuar është nxjerr në kundërshtim me nenin 65 të Ligjit për Zyrtarët Publikë. Kërkon që ankesa të aprovohet të pezullohet zbatimi i vendimit dhe të rishqyrtohet edhe njëherë çështja e transferimit.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i pretendimeve ankimore në ndërlidhje më provat materiale të çështjes konstaton se transferimi i ankuesit ka qenë si rezultat i zbatimit të masës disiplinore siç parashihet me nenin 64 paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ku thuhet : 1. *Transferimi i përhershëm është caktimi i detyrueshëm i nëpunëses/it civil në një pozitë tjetër të shërbimit civil, në rast: 1.5. të shqiptimit të transferimit si masë disiplinore*, pra në rastin konkret nuk gjejnë zbatim dispozitat e nenit 65 paragrafi 6 të LZP, ashtu siç pretendohet nga ankuesi.

Për me tepër, Kolegji ka gjetur se organi punëdhënës duke u bazuar në kualifikimin arsimor të ankuesit ka ofruar për ankuesin mundësinë e përzgjedhjes për dy pozita të lira dhe atë Zyrtar për Administrimin e Pronave-Zyra Regjionale në Pejë-profesional 2, grupi i administrimit të përgjithshëm dhe Zyrtar për Administrimin e Pronave-Zyra Regjionale në Prizren- profesional 2, grupi i administrimit të përgjithshëm, andaj, duke qenë se ankuesi nuk ka pranuar asnjërin nga to, atëherë Drejtoresha Ekzekutive e AKKVP-së në cilësi të titullarit të institucioni ka bërë transferimin e ankuesit në pozitën Zyrtar për Administrimin e Pronave-Zyra Regjionale në Prizren.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18, paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë-Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.33/2026

Merlinda RAMAJ

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit Y.D ;
- Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës: Drejtoreshës së Sekretarisë Ekzekutive dhe Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore
- Arkivit të KPMSHCK-së.